



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr. 144/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurve : F.A , sipas akuzës së PTH në Pejë PP.nr. 33/17 të dt.10.2.2017, për shkak të veprës penale :Lëndi i lehtë trupor nga neni 188 par 1 lidhur me nën par 1.4 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurve F. Aj , mbrojtësit të tij av. I. O. nga D. , i caktuar sipas autorizimit dhe të prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari me dt.10.10.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri F.A i lindur me dt. 20.2.1987 në fsh. ----- , ku edhe tani jeton, i biri i R. dhe nënës H e gjinisë B, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTËL FAJTOR :

Sepse :

I pandehuri Fisnik Alimusaj

Me dt. 28.12.2016 rreth orës 14:00 , në Pejë në fsh. Vitomericë Komuna e Pejës, në rrugën Agim Binak Qelaj , me dashje i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit D.A , në atë mënyrë që pasi që i dëmtuari dhe i pandehuri e kishin rrezikuar njëri tjetrin në komunikacion dhe duke bërë ekzibicione në komunikacion të njëjtit ndalojnë dhe sqarohen në mes veti , ashtu q pas një zënke të çastit , i pandehuri e sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me grusht dhe shpulla në kokë ku si pasoj e kësaj i dëmtuari pëson lëndime Jtë lehta trupore të përshkruara si në akt ekspertizën mjeko ligjore të dr. D. H. me numër të referencës PE-046/17 i dt. 22.1.2017

-me çka ka kryer veprën penale : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1e lidhur me nën par 1.4 të KPRK-së

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 41,42,43,46, dhe nenit 188 par 1 e lidhur me nën par 1.4 të KPRK-së, të pandehurin,

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej **200 € (dy qind) euro**, të cilën i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 3 muajsh , në rast të mospagimit gjoba në fjalë i zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur 20 € (njëzet) për 1 (një) ditë burgu .

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro , kurse në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 20– 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë

I dëmtuarit për realizimin eventual të kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt. 10.2.2017 kundër të pandehurve F.A dhe D. A ,ka ngritë aktakuzë dhe PP.nr. 33/17, për shkak të vepër penale të kryer secili veç e veç : Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 e lidhur me nën par 1.4 të KPRK-së, dhe vepër penale: asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurit ti shpallë fajtorë , ti dënoj sipas ligjit dhe ti obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Me dt. 10.10.2017, gjykata e ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin janë paraqitur prokurori i shtetit Muharrem Bajraktari, i pandehuri F.A si dhe mbrojtësin i tij av. I.O., nuk ka ardhur i pandehuri D. A, ku nga fletë kthesa rezulton se i njëjti është shpërngul nga ky vendbanim pa e njoftuar gjykatën fare për adresën e re , për çka gjykata për shkak të ekonomizimit të procedurës e ka bërë veçimin e lëndës- e sidomos për faktin se ë pandehurit pandehen për vepra të ndryshme secili veç e veç.

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri F.A – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasoja e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shteti, mbrojtësit të tij e ka pranuar , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë e ka pranuar

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kalon në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë , pa dënueshmërinë e mëparshme , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 10.10.2017

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet

Ankesa në afat prej 15 ditësh nga

Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë

E përmes kësaj Gjykate .